

Datë: 14.12.2023

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 14.12.2023 (dymijë e njëzetetë) në selinë e shoqërisë "DITEKO" SHPK në adresën Rruga "Donika Kastrioti", Nr. 4, Pallati Nr. 14, Tiranë, Shqipëri, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm:

- A. Z. Përparim Golli**, shtetas shqiptar, lindur më 4 Korrik 1970 në Dibër dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartën e identitetit nr. H00704128Q, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "**ME-AJ ENERGY**" SHPK, me **NIPT K81716010N** dhe adresë Rruga "Donika Kastrioti", Nr. 4, Pallati Nr. 14, Tiranë, Shqipëri.
- B. Z. Përparim Golli**, shtetas shqiptar, lindur më 4 Korrik 1970 në Dibër dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartën e identitetit nr. H00704128Q, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "**PERXHOLA**" SHPK, me **NIPT J921080080** dhe adresë Rruga "Donika Kastrioti", Nr. 4, Pallati Nr. 14, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në nenin 73/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" përpilohet kjo "Kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

Neni 1 Palët kontraktuese

1.1 Palë në këtë kontratë shit-blerje kuotash, nga këtu e në vijim referuar si kontrata, janë:

- A.** Shoqëria "**ME-AJ ENERGY**" SHPK, me NIPT K81716010N nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**"
- B.** Pala blerëse është shoqëria "**PERXHOLA**" SHPK, e NIPT J921080080 nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**"

1.2 Shitësi dhe blerësi, bashkërisht në kontratë, do të referohen si Palët.

Neni 2 Kushtet përpara lidhjes së kontratës

2.1. Shitësi është zotëruar me të drejta të plota i një kuote me pjesëmarrje 35% në kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK me NIPT K92108022E.

2.2. Shoqëria "DITEKO" SHPK ka si objekt të veprimtarisë së vetë: *Zbatimi i kontrates konçesionare me Autoritetin Kontraktues (Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) Nr.1924 Rep, Nr.230 Kol, date 03.06.2009 e miratuar me VKM Nr.701, date 11.06.2009 që ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr.114, date 24.07.2009 dhe konkretisht financimi, projektimi, ndertimi, testimi, kolaudimi, venia në punë, pronësia, administrimi, mirembajtja e kaskades së hidrocentraleve në lumin Zalli i Okshtunit dhe transferimi i tyre në përfundim të kontrates nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues konforme kushteve dhe afateve të kontrates së sipërpermendur. Prodhim të energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, djellore, e erës etj.*

"PERXHOLA" SHPK - "ME-AJ ENERGY" SHPK |



- 2.3. Shitësi ka rënë dakort që të shesë tek blerësi 7% (shtatë përqind) të kuotës që zotëron në kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK.
- 2.4. Blerësi ka interesin dhe mundësitë financiare e kapacitetet teknike për zhvillimin e objektit sipas Marrëveshjes së Koncesionit.

Neni 3 **Objekti i kontratës**

Shitësi i shet blerësit si më poshtë vijon:

- 3.1. Shoqëria **"ME-AJ ENERGY" SHPK** do t'i shesë shoqërisë **"PERXHOLA" SHPK**, 7% (shtatë përqind) të kuotës së saj pjesmarrëse në Kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK.
- 3.2. Blerësi blen kuotat e sipërcituara kundrejt pagimit të një shume të hollash e referuar nga këtu e më poshtë në kontratë si çmimi i shitjes.

Neni 4 **Çmimi i shitjes**

- 4.1. Çmimi total i shitjes së 7% (shtatë përqind) të kuotës së pjesmarrëse në Kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK objekt i kësaj kontrate, është ALL 38,600,100 (Tridhjetëetëtmilion e gjashtëqindmijë e njëqind Lekë)

Neni 5 **Mënyra e pagimit të çmimit të shitjes**

- 5.1 Çmimi i shitjes do të paguhet me kështu brenda një afati 5 (pesë) vjeçar, afat i cili fillon nga data e hyrjes në fuqi e kontratës.
- 5.2 Çmimi i shitjes do të paguhet në monedhën Lek në llogarinë bankare të bankave vëndase të shitësit, të përcaktuar nga vetë palët, jashtë kësaj kontrate.

Neni 6 **Të drejtat dhe detyrimet e shitësit**

- 6.1 Shitësi garanton se kuota e tij nuk është e lënë peng, në dorëzani apo e rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i saj e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 6.2 Për sa kohë kjo kontratë është në fuqi, çdo marrëveshje e bërë midis shitësit dhe çdo të treti tjetër është e pavlefshme edhe nëse marrëveshja është bërë përpara hyrjes në fuqi të kontratës.

Neni 7 **Të drejtat dhe detyrimet e blerësit**

- 7.1 Blerësi duhet të paguajë çmimin e shitjes sipas përcaktimeve në kontratë.
- 7.2 Blerësi, në çdo rast, do të bëhet menjëherë zotëruar (pronar) i kuotave të shitësit, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontratë.

Neni 8 **Kushtet pas lidhjes së kontratës**

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

- 8.1 Kuota e shitësit "ME-AJ ENERGY" SHPK ne Kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK, me shitjen e 7% (shtatë përqind) të saj, shkon në kuotë me pjesëmarrje 28% (njëzetë e tetë përqind).
- 8.1 Kuota e blerësit "PERXHOLA" SHPK në kapitalin e shoqërisë "DITEKO" SHPK, me blerjen e 7% (shtatë përqind), shkon në kuotë me pjesëmarrje 12% (dymbëdhjetë përqind).

Neni 9 Njoftimet

- 9.1 Çdo komunikim ndërmjet palëve do të bëhet duke i dërguar njoftimet përkatëse kur është rasti në adresat postare të përshkruara në kontratë, ose në adresat elektronike si më poshtë:

Për shitësin: perparimgolli@gmail.com

Për blerësin: info@perxhola.com

Neni 10 Rasti i forcës madhore

- 10.1 Rasti i Forcës Madhore do të thotë çdo rrethanë që nuk është në mënyrë të arsyeshme në kontrollin e palës që e pretendon dhe që nuk mund të parandalohet se shmangej në mënyrë të arsyeshme dhe që si rezultat i së cilës, pala që pretendon Rastin e Forcës Madhore e ka të pamundur të përmbushë një ose disa prej detyrimeve të saj duke përfshirë por pa u kufizuar në: katastrofat e natyrës, përmbytjet e tërmetet aksidentet e rënda teknologjike, lufta, konfliktet e armatosura, lufta civile, aktet terroriste, embargo që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj.
- 10.2 Mbi njoftimet, pasojat dhe zgjidhjen e kontratës, në Rastin e Forcës Madhore palët do t'i referohen në mënyrë analoge për sa është e mundur nenit 20 e vijues së Marrëveshjes së Konçesionit.

Neni 11 Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Kontrata hartohet në tre ekzemplarë me fuqi të njëjtë ligjore.
- 11.2 Kontrata është hartuar dhe do të interpretohet e zbatohet sipas ligjit shqiptar.
- 11.3 Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kontratës është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 12 Hyrja në fuqi e kontratës

- 12.1 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

SHITËSI

"ME-AJ ENERGY" SHPK

"PERXHOLA" SHPK - "ME-AJ ENERGY" SHPK

BLERËSI

"PERXHOLA" SHPK

NDËRTIM
PERXHOLA sh.p.k.
TIRANË - ALBANIA